



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion**

**Mbledhja nr. 19/2009**  
**Më 22. 06. 2009, në orën 12:00**  
**Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225**

**Procesverbal**

**Në mbledhje morën pjesë:** Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Fatmir Rexhepi, Sala Berisha – Shala, Mufëra Şinik, Berim Ramosaj dhe Zef Morina.

**Munguan:** Slobodan Petroviq, Kaqusha Jashari dhe Safete Hadërgjonaj.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Hakif Jashari, Dukagjin Shala dhe Ismet Shala – MEM, Lejla Selimi – OSBE, Besim Zeqiri – ICO, Bill Klawonn dhe Haxhi Gashi – USAID, Ramadan Klisurica – KDI, Shefki Kastrati – NDI dhe Ibrahim Krasniqi – konsulent i Komisionit.

**Nga Zyra Mbështetëse:** Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

**Mbledhjen e drejtoi:** Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 09. 06. 2009;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për miniera dhe minerale;
4. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/11 për rrugët;
5. Të ndryshme.

## **I. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

## **II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 09. 06. 2009**

Procesverbali i mbledhjes së 09. 06. 2009 u miratua pa vërejtje.

## **III. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për miniera dhe minerale**

**Kryetarja** – Kërkoj nga deputetët të deklaroreshin në parim për Projektligjin për miniera dhe minerale. Njëkohësisht propozoi deputeten, Sala Berisha – Shala, të jetë raportuese e grupit të punës për këtë projektligj.

**Sala Berisha – Shala** – Duke e vlerësuar shumë të rëndësishëm këtë projektligj, theksoi se e përkrah në parim Projektligjin, kurse vërejtjet dhe sugjerimet do t'i paraqesë në seancë plenare.

**Ethem Çeku** – Tha se materiali i Projektligjit është marrë shumë vonë dhe nuk kishte pasur kohë ta shqyrtonte. Komisioni duhet të jetë i kujdesshëm në një rast të tillë, siç është çështja e menaxhimit të resurseve minerale, sepse janë të një rëndësie të veçantë. Kërkoj që së pari të organizohet debat publik në lidhje me këtë çështje dhe pastaj të procedohet në seancë.

**Sala Berisha – Shala** – Tha se sipas procedurës së Rregullores së punës, një dëgjim publik për një projektligj, mund të realizohet pas leximit të parë në seancë plenare dhe nuk ka mundësi procedurale të zhvillohet debat para se të miratohet në seancë plenare.

**Ethem Çeku** – Shfaq brengosje se duhet të përcaktohet raporti ndërmjet Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (tutje: KPMM) dhe Ministrisë së Energjisë dhe të Minerave (tutje: MEM), në caktimin e kompetencave dhe të licencave, pastaj konflikti i interesit etj. Kërkoj kohë shtesë për shqyrtimin e tij dhe deklaroi se do të abstenojë me rastin e votimit.

**Zef Morina** – Tha se pajtohet me vërejtjet e paraqitura, mirëpo propozoi të miratohet në parim ky projektligj, pastaj Grupi i punës të organizojë dëgjim publik dhe mund të amendamentohen këto vërejtje.

**Berim Ramosaj** – Nëse Komisioni Funkcional do të kishte hapësirë veprimi para miratimit në seancë, mund ta shtyjmë edhe për një javë shqyrtimin në parim, mirëpo, nëse nuk bëhet kjo, atëherë mund ta procedojmë për në seancë plenare.

**Kryetarja** – Tha se Kryesia e Kuvendit edhe pa miratimin tonë mund ta radhitë Projektligjin për seancë plenare, sepse këtë mundësi ia jep Rregullorja e punës së Kuvendit.

**Sala Berisha – Shala** – Sqaroi anën procedurale. Komisionit mund t'i jepet vizë më një votim në parim dhe ta procedojë në Kuvend. Pas miratimit në parim në Kuvend, Komisioni mund ta realizojë atë që kërkohet dhe të organizohet dëgjim publik, në të cilin do të ftoheshin ekspertë të kësaj fushe, pastaj të bëhen amendamentet aty ku shihet e nevojshme.

**Fatmir Rexhepi** – Vlerësoi se koha e shqyrtimit të Projektligjit është e shkurtër dhe kërkoi së paku një javë. Pastaj Komisioni mund të japë opinionin se a është pro miratimit në parim apo jo. Mirëpo, në qoftë se procedura mund të shkojë edhe pa mendimin e Komisionit, atëherë le të procedohet për Kuvend.

**Kryetarja** - Ua dha fjalën përfaqësuesve të MEM-it dhe të USAID-it për t'i paraqitur opinionet në lidhje me këtë projektligj.

**Hakif Jashari - u.d. i sekretarit të përhershëm në MEM** – Theksoi se Projektligji është hartuar nga ekspertë të brendshëm, nga të jashtëmit dhe nga ekspertë të KPMM-së. Në veçanti i falënderoi ekspertët e USAID-it për kontributin e dhënë në këtë drejtim. Shtoi se kemi miratimin me shkrim edhe nga Agjencia për Zhvillim dhe Integrim Evropian se ky projektligj është në përputhje me legjislacionin evropian dhe mund të procedohet në Kuvend për miratim. Duke u ndalur te kompetencat e Inspektoratit, theksoi se kjo çështje është rregulluar dhe nuk paraqet kurrfarë konflikti të interesit ndërmjet MEM –it dhe KPMM-së.

**Bill Klawonn - USAID** - Tha se ky projektligj është hartuar mirë dhe në bazë të standardeve evropiane dhe e shfuqizon legjislacionin që është në fuqi të kësaj fushe. Mirëpo kjo nuk do të thotë që ky draft duhet të shkojë në formën e tanishme.

Pas debatit të gjerë Komisioni nxori këtë

### **Përfundim**

- I. Shtyhet për mbledhjen e radhës shqyrtimi në parim i Projektligjit për miniera dhe minerale.

### **IV. Shqyrtimi i Raportit për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/11 për rrugët**

**Zef Morina** – Kishte vërejtje në pikën gjashtë (6) të Raportit për mirëmbajtjen e shenjave të trafikut dhe kërkoi që fjalia të riformulohet, si vijon:

Neni 13.1. i detyron Ministrinë, përkatësisht komunat për mirëmbajtjen e shenjave të trafikut në: autoudhë, në rrugë magjistrale, në rrugë rajonale dhe në rrugë lokale.

Pas diskutimeve Komisioni nxori këtë

### **Përfundim**

- I. Miratohet Raporti për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2003/11 për rrugët.
- II. Kryesia e Kuvendit ta procedojë Raportin në seancë plenare.

### **V. Të ndryshme**

#### **a) Projektligji për standardizim**

**Kryetarja** – Njoftoi Komisionin se në një afat të afërt do të silllet në shqyrtim Raporti i Projektligjit për standardizim.

#### **b) Projektligji për gazin natyror**

**Sala Berisha – Shala** – Theksoi se grupi i punës është në fazën e përmbylljes së amendamentimit të këtij projektligji dhe në mbledhjen e radhës do ta sjellë Raportin për shqyrtim në Komision.

**Ethem Çeku** – Pyeti raportuesen për kërkesën që ka shtruar në mbledhjen e kaluar për organizimin e dëgjimit publik për këtë projektligj.

**Sala Berisha – Shala** – Sqaroi se është vonë të organizohet dëgjimi publik për këtë projektligj, sepse grupi i punës i ka hartuar pothuajse të gjitha amendamentet e mundshme dhe është në kundërshtim më procedurat e Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

Kryetarja e Komisionit

---

Myzejene Selmani